

VENDIM
Nr. 936, datë 18.11.2015

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BRENDA PROGRAMEVE BUXHETORE TË
MIRATUARA PËR MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.1998, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2015 të bëhet rishpërndarja e fondeve brenda programeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Punëve të Brendshme, si më poshtë vijon:

a) Për programin “Policia e Shtetit”, në artikullin 231 “Shpenzime për investime”, të shtohet fondi 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve në investime për projektin “Blerje pajisjesh për Policinë e Rendit”;

b) Për programin “Emergjenca civile”, në artikullin 604 “Transferata korrente të brendshme”, të shtohet fondi 61 584 000 (gjashtëdhjetë e një milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve për rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar, dëmshpërblimin e familjeve, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme, si dhe fond rezervë për të përballuar emergjencat e pritshme dimërore;

c) Fondi prej 88 584 000 (tetëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekësh të përballohet nga pakësimi i buxhetit për programin “Planifikim menaxhimi” në zërin “Shpenzime korrente” dhe “Shpenzime për investime”.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama